



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bushi, Ndertesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 1145
Datë: 29 / 6 / 2020

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.01.2020, mori këtë:

V E N D I M

1. Revista shkencore "International Journal of Research in Business and Social Science", për shkak të dëmtimit të kredibilitetit nuk do të merret në konsideratë për vlerësim me rastin e emërimit, riemërimit dhe avancimit të personelit akademik si dhe për aprovimin e punimit të doktoratës së doktorantëve të UP-së.
2. Ky vendim hyn në fuqi nga data e miratimit në Senat dhe ka efekt retroaktiv për të gjitha publikimet e bëra në këtë revistë në revistë shkencore.

Arsyetim

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur në datën 14.01.2020, konstatoi se revista me titull "International Journal of Research in Business and Social Science", edhe pse është e listuar në data bazat e përcaktuara nga Senati i UP-së, për shkak të humbjes së kredibilitetit nuk do të merret në konsideratë me rastin e emërimit, riemërimit dhe avancimit të personelit akademik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", si dhe avancimit për aprovimin e punimit të doktoratës së doktorantëve të ri.

Arsyet për mos pranimin e publikimeve në këtë revistë shkencore, me rastin e emërimit, riemërimit dhe avancimit të personelit akademik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" si dhe për aprovimin e punimit të doktoratës qëndrojnë në kredibilitetin e revistës në fjalë, në të cilën kohëve të fundit janë publikuar artikuj të dyshimtë shkencor, prandaj duke pasur se synim kryesor i UP-së është avancimi i mëtejshëm i punimeve shkencore, Senati i UP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. KQSD-së,
3. Njësive akademike të UP-së,
4. Zyrës për Çështje Akademike,
5. Zyrës ligjore të UP-së,
6. Ueb faqe të UP-së



Senati i Universitetit të Prishtinës

Prof. Dr. Marjan Dema – Rektor i UP-së